



Në bazë të nenit 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 dhe nenit 25 pika 9 të Statutit të Komunës së Deçanit, në mbështetje të Udhëzimit Administrativ nr.23/2016 për Planin Zhvillimor të shkollës dhe Planin zhvillimor Komunal të Arsimit, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e vet të mbajtur me dt.28.02.2018, bie këtë:

V E N D I M

MBI FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR TË ARSIMIT NË KOMUNËN E DEÇANIT

I.

Formohet komisioni për hartimin e Planit Zhvillimor të Arsimit në Komunën e Deçanit, në këtë përbërje:

1. Qazim Maloku, 2.Xhevat Bozhdaraj, 3.Hysen Balaj, 4.Enver Osdautaj, 5.Saniye Thaqi, 6.Fatjeta Ramaj dhe 7.Sylejman Lokaj,

Kryesuesi i Kuvendit e fton mbledhjen e parë të komisionit, në të cilën mbledhje komisioni e zgjedh kryetarin nga radhët e veta.

II.

Detyrë e Komisionit është:Hartimi i Planit Zhvillimor të arsimit me të cilin definoohen prioritetet dhe objektivat për përmirësimin e cilësisë së arsimit në periudhën afatmesme kohore duke u bazuar në analizën e situatës aktuale të arsimit në komunë si dhe planeve zhvillimore shkollore të shkollave në nivel komune.

Pas përfundimit të PZHKA, Komisioni harton raportin dhe ia dorëzon materialin për shqyrtim dhe miratim KPF-së dhe Kuvendit.

III.

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Arsim.

IV.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

V.

Me Vendim paisen të përmendurit në pikën I. Të Vendimit, Drejtoria për Arsim dhe Arhivi i Komunës.

01.Nr.II-7

Deçan,dt.28.02.2018

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi:
Haki Shehaj

Stamp and signature area at the bottom left of the document.